

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Malishevës z. Isni Kilaj**

I nderuari z. Kilaj,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7 – 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Investime në vlerë rreth 52 milionë euro, apo 13 milionë euro investime për çdo vit gjatë mandatit 4 vjeçar;
- Për fshatin Pagarushë: ngritjen e një liqeni artificial, ndërtimin e objekteve të reja shkollore, sistemin e kanalizimit, dhe ujësjellësin;
- Për fshatin Dragobil: rregullimin e rrjetit energjetik, riparimin e ujësjellësit, rregullimin e rrugëve dhe mini parqeve, dhe rregullimin e trotuarit;
- Për banorët e fshatit Banjë: ndërtimin i një shkolle të ciklit të mesëm të ulët;
- Për banorët e fshatit Gurishtë: Ndërtimin e një shkolle të re;
- Për fshatin Drenofc: rregullimin e ujësjellësit, kanalizimit dhe trotuareve;
- Për fshatin Lumishtë: ndërtimin e trotuareve, asfaltimin e rrugëve nëpër lagje të fshatit, ndërtimin e një fushe futbolli, dhe ndriçimin;
- Përkujdesje të veçantë për veteranët e luftës dhe kategoritë tjera të dala nga lufta;
- Shndërrimin e Drenofcit dhe katër fshatrave të tjera në qyteza;
- Investime në sektorin e turizmit dhe blegtorisë;
- Ndërtimin e Qendrës së Emergjencës;
- Mbrojtjen e ambientit, posaçërisht mbrojtjen e lumit Mirusha;
- Sigurimin e udhëtimit për në shkollë për nxënësit e fshatit Janishiq;
- Ndërtimin e shkollës ,bashkë me terren sportiv dhe sallën e kulturës, në fshatin Tërpezë e Ulët;
- Ndërtimin e ujësjellësit në dy fshatra (nëse gjinden burimet e ujit);
- Riparimin dhe funksionalizimin e sistemit të ujësjellësit dhe atë të rrjetit energjetik në Maxharrë;
- Furnizimin me ujë për lagjen Hot, premtim që do të përmbushet në 2010;
- Rëndësi e veçantë do ti kushtohet rinisë dhe sportit, ku brenda mandatit katër vjeçar Malisheva do të ketë Shtëpi të Kulturës, Pallat të Sportit, Muze të qytetit, shkolla profesionale, stadium futbolli;
- Ndërtimin e kolektorit për ujërat e zeza (projekt i cili do të përfundohej në vitin 2011 në vlerë prej 500 mijë euro).

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)